

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SHBA i dha vizën, Sali Berisha do të shkojë nesër në Ambasadë për të tërhequr pasaportën (DETAJET) - Shekulli
ADRESA	https://shekulli.com.al/2026/08/31/shba-i-dha-vizen-sali-berisha-do-te-shkoje-neser-ne-a- mbasade-per-te-terhequr-pasaporten-detajet/
BURIMI	shekulli.com.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 01:14:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 600 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	31 gusht 2026, 16:33:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bda1282109557ed9674a12bf003f5fcbf21b6e095cb5d207a8568a228dda761d
TEKSTI	6f089925bb81cddb43e6fcbf4cc32cacd63a53167bd58a0791a5fc4dc5358e422
PAMJA	35afa1f7412cea896162e2e7aef694ba95b3cbb7df8bac7b50daa4b31cd95623

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3d7419157fcdd6043b61cc93cde76ca34a3552f33f719bb1f4ae60537f3a1439
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a42b88253b0c340fa02f24259d251e6e75ce4082f988432cb85d4a7dbcc5f14a
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmdqGnQa4A7QNVpS9UHf8WEnDu7RrktK9ksoi2Va5qXNty



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3d7419157fcdd6043b61cc93cde76ca34a3552f33f719bb1f4ae60537f3a1439>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

×

- [HOME](#)
- [POLITIKË](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KRONIKË](#)
- [BOTA](#)
- [REAL ESTATE](#)
- [EMIGRANTËT](#)
- [SPORT](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [EXTRA](#)
- [OPINION](#)

Rr. Ismail Qemali, Pallati 18, Kati 1, 1001, Tiranë, Shqipëri
"Shekulli Group"



SHBA i dha vizën, Sali Berisha do të shkojë nesër në Ambasadë për të tërhequr pasaportën (DETAJET)

Publikuar më **31.08.2026** nga **Shek**

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, është pajisur me vizën amerikane, duke hapur rrugën udhëtimit të tij drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ish-kryeministri pritet që ditën e nesërme të paraqitet pranë Ambasadës së SHBA-së në Tiranë për të tërhequr pasaportën me vizën në të.

Për zhvillimin ka reaguar edhe deputeti demokrat Belind Këlliçi, i cili përmes një postimi në rrjetet sociale ka shkruar: "Bac u kry", shoqëruar me flamurin amerikan.

Sipas informacioneve të bëra publike, Berisha pritet të udhëtojë drejt Shteteve të Bashkuara në ditët e para të shtatorit. Udhëtimi lidhet me pjesëmarrjen e tij në një aktivitet të Partisë Republikane amerikane, i cili pritet të zhvillohet në Dallas më 9 dhe 10 shtator.

Çështja e vizës amerikane vjen në një moment kur në muajt e fundit është diskutuar gjerësisht edhe statusi i Berishës në raport me vendimin e heqjes së "non gratës" të marrë nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Sali Berisha u shpall "non grata" nga Departamenti Amerikan i Shtetit më 19 maj të vitit 2021. Në atë kohë, autoritetet amerikane e akuzuan për përfshirje në korrupsion të nivelit të lartë, duke përmendur keqpërdorimin e fondeve publike dhe ndërhyrjen në procese publike për përfitime personale dhe politike.

Vendimi përfshinte edhe familjarë të tij dhe solli ndalimin e hyrjes në territorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Berisha e kundërshtoi vendimin, duke e cilësuar atë si politik dhe duke mohuar akuzat e ngritura ndaj tij.

Shpallja "non grata" pati pasoja të rëndësishme në Partinë Demokratike. Në shtator 2021, kryetari i atëhershëm i PD-së, Lulzim Basha, vendosi përjashtimin e Berishës nga grupi parlamentar i partisë. Ky vendim shënoi nisjen e një përplasjeje të fortë brenda PD-së, e cila më pas çoi në lëvizjen e "Rithemelimit" dhe rikthimin e Berishës në krye të partisë.


Në vitin 2023, Berisha u vendos në masën e sigurisë "arrest shtëpie" në kuadër të hetimeve për dosjen "Partizani". Ai e ka konsideruar këtë proces politik dhe ka mohuar akuzat.

Pas më shumë se një viti, në fund të vitit 2024, Berisha u lirua nga masa e "arrestit në shtëpi" dhe vijoi aktivitetin e tij politik.

Me Berishën në SHBA pritet të udhëtojnë edhe kryetari i Partisë Republikane, Fatmir Mediu, deputetët Belind Këlliçi dhe Albana Vokshi, si dhe Enri Ceno, ekspert për marrëdhëniet ndërkombëtare në Partinë Demokratike.

Për t'u bërë pjesë e grupit të "Shekulli" mjafton të klikoni: [Join our FB Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet.

KOMUNITETI SHEKULLI ONLINE: <https://www.facebook.com/groups/1381242728701899/>



[Nga protesta e 100-të tek rrethimi i Kuvendit/ Çfarë do të ndodhë me “flamingot” më 7 dhe 8 shtator](#)


[Nga protesta e 100-të tek rrethimi i Kuvendit/ Çfarë do të ndodhë me “flamingot” më 7 dhe 8 shtator](#)

Publikuar më 06.09.2026

“Revolucioni Flamingo” shënon ditën e nesërme protestën e 1...

“Revolucioni Flamingo” shënon ditën e nesërme protestën e 100-të, që kur qytetarët zbritën në shesh. Tubimet që nisën si kundërshtim për projektin e planifikuar për tu ndërtuar në zonën e Zvërmecit dhe në ishullin e Sazanit, shumë shpejt u kthyen në protesta të mëdha, kundër qeverisë, kryeministrit Edi Rama por edhe të gjithë klasës politike. [...]

[Lexo më shumë](#)



[Video/ Dy ditë pas zjarrit katastrofik, Vangjel Tavo zbret në terren: Prioriteti ynë është të jemi pranë banorëve](#)


[Video/ Dy ditë pas zjarrit katastrofik, Vangjel Tavo zbret në terren: Prioriteti ynë është të jemi pranë banorëve](#)

Publikuar më 06.09.2026

Kryebashkiaku i Himarës Vangjel Tavo ka zbritur në terren pa...

Kryebashkiaku i Himarës Vangjel Tavo ka zbritur në terren pas zjarreve që goditën qytetin në jug të vendit. Tavo ka publikuar disa pamje në rrjetet sociale, ku shfaqet pranë qytetarëve, të cilëve iu dogjën banesat apo tokat gjatë zjarrit katastrofik, dy ditë më parë. Tavo tha se ekipet po evidentojnë dëmet dhe po qëndrojnë pranë [...]

[Lexo më shumë](#)



[“Ata që përgatitën mashtrimin, janë pas hekurave”/ Berisha nga SHBA-ja për “non grata”-n: Qëndroj me dy këmbë në tokën që donin të ma ndalonin](#)


[“Ata që përgatitën mashtrimin, janë pas hekurave”/ Berisha nga SHBA-ja për “non grata”-n: Qëndroj me dy këmbë në tokën që donin të ma ndalonin](#)

Publikuar më 06.09.2026

Kryedemokrati Sali Berisha ndodhet në Shtetet e Bashkuara të...

Kryedemokrati Sali Berisha ndodhet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ka zhvilluar një takim me shqiptarët në New Jersey. Berisha është ndalur të flasë edhe për shpalljen “non grata” nga DASH 5 vite më parë, duke thënë se sanksionet erdhën pas mashtrimit të krijuar nga ekstremi i majtë. Ai shtoi se sot ata janë [...]

[Lexo më shumë](#)



[“Talent i madh politik por nuk e mbajti dot peshën e pushtetit”/ Ja për kë i thotë këto fjalë Edi Rama](#)

[“Talent i madh politik por nuk e mbajti dot peshën e pushtetit”/ Ja për kë i thotë këto fjalë Edi Rama](#)

Publikuar më 06.09.2026

Kryeministri Edi Rama njoftoi sot rinisjen e podkastit “Flasim...”

Kryeministri Edi Rama njoftoi sot rinisjen e podkastit “Flasim”, ku në episodin e parë u shfaq përballë gazetares Rudina Xhunga. Aju e pyet mes të tjerash edhe për Ilir Metën, të cilin Rama e përshkruan si një “talent politik”. Megjithatë, Rama shton se Meta nuk e mbajti dot peshën e pushtetit dhe u shndërrua në [...]

[Lexo më shumë](#)

[Ngërçi me pagat e magjistratëve, reagon Rama: Vetë Gjykata Kushtetuese po pret parlamentin! Çdo koment tjetër është humbje kohe](#)

[Ngërçi me pagat e magjistratëve, reagon Rama: Vetë Gjykata Kushtetuese po pret parlamentin! Çdo koment tjetër është humbje kohe](#)

Publikuar më 06.09.2026

Kryeministri Rama ka reaguar në lidhje me ngërçin e krijuar ...

Kryeministri Rama ka reaguar në lidhje me ngërçin e krijuar për pagat e gjyqtarëve në vend. Në një reagim në rrjetet sociale, Rama shprehet se secili institucion duhet të jetë në vendi në vet. Teksa ndaj një video ku paraqitet një pjesë e konferencës së ministrit të Drejtësisë, Rama thotë se vetë Gjykata Kushtetuese është [...]

[Lexo më shumë](#)

[“Pasardhësi duhet të të vrasë”/ Rama flet për largimin nga politika: Do shpëtoni nga unë në momentin që do kaloj atë prag](#)

[“Pasardhësi duhet të të vrasë”/ Rama flet për largimin nga politika: Do shpëtoni nga unë në momentin që do kaloj atë prag](#)

Publikuar më 06.09.2026

Kryeministri Edi Rama ka njoftuar mëngjesin e sotëm se së sh...

Kryeministri Edi Rama ka njoftuar mëngjesin e sotëm se së shpejti pritet të rikthehet podkasti i tij “Flasim”. Në një postim në rrjetet sociale, Rama ka publikuar një përmbledhje të shkurtër nga episodi i parë i sezonit të ri, ku ai do të jetë përballë pyetjeve të Rudina Xhungës. Në video, Rama flet për aktualitetin [...]

[Lexo më shumë](#)

[Himara nën tiakë, “zhduket” Vangjel Tavo, kryebashkiaku mungoi edhe gjatë vizites së Ramës](#)

[Himara nën flakë, “zhduket” Vangjel Tavo, kryebashkiaku mungoi edhe gjatë vizitës së Ramës](#)

Publikuar më 05.09.2026
Kryeministri Edi Rama ka vizituar sot nga pranë qytetin e Hi...

Kryeministri Edi Rama ka vizituar sot nga pranë qytetin e Himarës, i cili dje u përfshi nga një zjarr masiv që la pas shtatë banesa të djegura dhe një sipërfaqe të madhe me ullishte të shkretuar. I shoqëruar nga ministri i Brendshëm, Besfort Lamallari, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skënder Hita dhe zyrtarë [...]

[Lexo më shumë](#)

[“Ç’nuk na vret na bën më t’fortë”, Rama viziton zonat e prekura nga zjarret në Himarë \(VIDEO\)](#)

[“Ç’nuk na vret na bën më t’fortë”, Rama viziton zonat e prekura nga zjarret në Himarë \(VIDEO\)](#)

Publikuar më 05.09.2026
Kryeministri Edi Rama ishte pasditen e sotme në Himarë, e ci...

Kryeministri Edi Rama ishte pasditen e sotme në Himarë, e cila dje u përfshi nga një zjarr masiv që la pas shtatë banesa të djegura dhe një sipërfaqe të madhe me ullishte të shkretuar. I shoqëruar nga ministri i Brendshëm, Besfort Lamallari, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skënder Hita dhe zyrtarë të tjerë, [...]

[Lexo më shumë](#)

Rr. Ismail Qemali, Pallati 18, Kati 1, 1001, Tiranë, Shqipëri

Redaksia:
[\[email protected\]](#)

Marketing:
[\[email protected\]](#)
[Politikat e privatësisë](#)
“Shekulli Group”

SHEKULLI © 2023 [Web Maintained by evolve.al](#)